



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:080096  
Datë: 12.02.2024  
Numri i dokumentit: 05312240

Pml.nr.65/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit R. I., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 181 par.1 nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPR), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësja e të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1637/2023 të datës 28.04.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.955/2023 të datës 29.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 6 shkurt 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit R. I. e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1637/2023 të datës 28.04.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.955/2023 të datës 29.09.2023.

**A r s y e t i m**

## **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.1637/2023 e datës 28.04.2023, të dënuarin R. I. e ka shpallur fajtor për shkak të penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 181 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së duke e gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej ... muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.03.2023 deri me datë 28.04.2023. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej ... €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej ... € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.955/2023 e datës 29.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të dënuarit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

## **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit R. I., avokate Bedrie Rexhepi nga Prishtina, pa përcaktuar bazën ligjore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara përkitazi me sanksionin penal ose aktgjykimet e kundërshtuara të i anuloj dhe çështjen ta kthen në rigjykim.

## **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.37/2024 e datës 01.02.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

## **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë mbrojtësja e të dënuarit thekson faktin se përkundër se i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare duke shprehur keqardhje dhe kërkuar falje, megjithatë kjo nuk është reflektuar në dënimin e ashpër të shqiptuar kundër tij.

Pretendohet se dy instancat më të ulëta gjyqësore nuk kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat lehtësuese se i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë, se është thellë i penduar për veprimet e tij, po ashtu nuk janë çmuar mjaftueshëm edhe rrethanat personale dhe karakteri i të dënuarit, përkatësisht bashkëpunimi i tij me gjykatë, sjelljet e tij korrekte, dhe të dhënat familjare të tij se vazhdon të bashkëjetoj me bashkëshorten e tij- të dëmtuarën dhe një fëmijë të përbashkët të moshës së mitur e gjithashtu se me të dëmtuarën tani më kanë tejkaluar problemet dhe mosmarrëveshjet e mëparshme, ashtu që edhe me një dënim më të butë do të arrihej qëllimi i dënimit.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtëses së të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke vlerësuar pretendimet e të dënuarit fillimisht duhet theksuar faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar dhe në prani të mbrojtësit të tij kishte bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPP-së, atëherë pranimi i fajësisë është aprovuar.

Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, del se kontestohet vendimi për dënimin për të cilën bazë kërkesa nuk mund të ushtrohet. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPP-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, vendimi për dënim nuk mund të kundërshtohet, kurse shkelja e ligjit penal vlerësohet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkaluar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të

shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Për më tepër, nga përmbajtja e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe veçanërisht aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit janë marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara sipas dispozitave ligjore dhe të dënuarit i është shqiptuar dënim në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.65/2024, më 6 shkurt 2024

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Rasim Rasimi